



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



PËRMBLEDHJE E INVESTIMEVE KAPITALE TË KRU-VE TË PLANIFIKUARA PËR: 2009-2011

Departamenti për Financa dhe Tarifa, ZRRUM/Prishtinë



Prishtinë, Korrik 2009

Parathënie

Ky dokument është punuar, para se gjithash për informim të zyrtarëve të ZRRUM-it me disa nga të dhënat lidhur me investimet kapitale sipas projekteve të planifikuara nga KUR-të dhe të lejuara nga DFT/ZRRUM për periudhën 2009-2011. Por, kjo përmbledhje si e tillë, mund t'iu shërbejë edhe palëve tjera të interesit dhe publikut të gjerë për tu informuar edhe ata për rrjedhat e pritshme në sektorin e shërbimeve të ujit gjatë periudhës së vlefshmërisë së tarifave ekzistuese.

“Pa ujë nuk ka jetë. Uji është e mirë materiale, e nevojshme për përdorim të çdonjërit. Resurset e ujërave të ëmbla nuk janë të pashtershme. Është e domosdoshme që ato të ruhen, kontrollohen dhe nëse është e mundur të rritet kapaciteti i tyre.”

(Karta Evropiane mbi Ujërat)

Përmbajtja

1. SFONDI	5
1.1 Zhvillimet në Sektorin e Ujit pas luftës në Kosovë.....	5
1.2 Kapacitet Ujore në Kosovë.....	6
2. INVESTIMET KAPITALE NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE TË UJIT	7
2.1. Investimet Kapitale në frymën e procesit tarifar.....	7
2.2 Lartësia e Investimeve Kapitale në Sektorin e Shërbimeve të Ujit.....	7
3. PËRSHKRIMI I INVESTIMEVE KAPITALE SIPAS KRU-ve	9
3.1. Kompania e Ujësllësit Regjional “Prishtina” – Sh. A. Prishtinë.....	9
3.1.1. Pasqyra Tarifore e KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë për vitet 2009 -2011	10
3.1.2. Investimet Kapitale të KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë për vitet 2009 -2011	10
3.1.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësllësit	11
3.1.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Kanalizimit Ujërave të Zeza	15
3.2. Kompania e Ujësllësit Regjional “Radoniqi” – Sh. A. Gjakovë.....	17
3.2.1 Pasqyra Tarifore e KUR “Radoniqi” Sh. A. Gjakovë për vitet 2009 -2011	18
3.2.2. Investimet Kapitale të KUR “Radoniqi” Sh. A. Gjakovë për vitet 2009 -2011	18
3.2.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësllësit	18
3.2.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujërave të Zeza.....	20
3.3. Kompania e Ujësllësit Regjional “Hidrodrini” – Sh.A. Pejë.....	21
3.3.1. Pasqyra tarifore e KUR “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitet 2009-2011	22
3.3.2. Investimet Kapitale të KUR “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitet 2009 -2011	23
3.3.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësllësit	23
3.3.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujërave të Zeza.....	24
3.4. Kompania e Ujësllësit Regjional “Mitrovica”–Sh.A. Mitrovicë.....	26
3.4.1. Pasqyra Tarifore e KUR “Mitrovica” Sh. A. Mitrovica për vitet 2009 -2011	27
3.4.2. Investimet Kapitale të KUR “Hidrodrini” Sh. A. Mitrovicë për vitet 2009 -2011	27
3.4.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësllësit	27
3.4.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujërave të Zeza.....	28
3.5. Kompania e Rajonale e Ujësllësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren.....	29
3.5.1. Pasqyra Tarifore e KUR “Hidroregjioni-Jugor” Sh. A. për vitet 2009 -2011.....	30
3.5.2. Investimet Kapitale të KUR “Hidroregjioni Jugor” Sh. A. Prizren për vitet 2009 -2011.....	30
3.5.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësllësit	30
3.5.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujërave të Zeza.....	32
3.6. Kompania e Ujësllësit Regjional Rajonal “Bifurkacioni”–Sh.A. Ferizaj.....	33
3.6.1. Pasqyra Tarifore e KUR “Bifurkacioni” Sh. A. Ferizaj për vitet 2009 -2011	34
3.6.2. Investimet Kapitale të KUR “Bifurkacioni” Sh. A. Ferizaj për vitet 2009 -2011	34
3.6.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësllësit	34
3.6.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujërave të Zeza.....	35
3.7. Kompania e Ujësllësit Regjional “Hidromorava” – Sh.A. Gjilan	37
3.7.1. Pasqyra Tarifore e KUR “Hidromorava” Sh.A. Gjilan për vitet 2009 -2011	38
3.7.2. Investimet Kapitale të KUR “Hidromorava” Sh. A. Gjilan për vitet 2009 -2011	38
3.7.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësllësit	38
3.7.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujërave të Zeza.....	39
4. KONKLuzionET	40

1. SFONDI

1.1 Zhvillimet në Sektorin e Ujit pas luftës në Kosovë

Pas luftës së fundit të vitit 1999 Kosova trashëgoi një infrastrukturë të shkatërruar ku bën pjesë edhe sektori e ujit të pijshëm dhe kanalizimit. Në atë periudhë kohore llogaritej se përafërsisht 49 % e popullatës kishin qasje në sistemet publike për furnizim me ujë të pijes dhe vetëm 21 % të asaj pjesë në rrjetin e grumbullimit të ujërave të ndotura. Pjesa tjetër e popullatës shfrytëzonte ujin nga pusët, pa kurrfarë përpunimi elementar, e në anën tjetër gropat septike dhe rrjedhjet e lira të ujërave të zeza të saj sot e kësaj dite janë ende aktuale për këtë pjesë të popullatës në gjithë vendin.

Pas aprovimit të Rregullores së UNMIK-ut (2002/12) të vitit 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), të njëjtit iu dhanë autorizimet për administrimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe publike ku bënë pjesë edhe ndërmarrjet e ujësjellësve dhe kanalizimeve të Kosovës. Njëri ndër hapat e parë të marra nga AKM-ja në sektorin e ujit ishte konsolidimi i 34 ndërmarrjeve publike shoqërore, në 7 kompani regjionale. Kjo iniciativë e filluar gjatë vitit 2002 ka përfunduar në vitin 2007 kur është bërë vlerësimi i aseteve dhe të njëjtat janë shndërruar në shoqëri aksionare të këtij sektori.

Me qëllim të kompletimit institucional të sektorit të ujit afërsisht në të njëjtën kohë kanë filluar përgatitjet për themelimin e Zyrës Rregullore për Ujë dhe Mbeturina, i cili si organ i pavarur do të merrej me rregullimin ekonomik të kompanive regjionale të shërbimit të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave. Themelimi i kësaj zyre është bërë me rregulloren e UNMIK-ut 2004/49, më 26 nëntor 2004 e cila pastaj është amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-086 të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më datë 13 Qershor 2008 duke transferuar kështu përgjegjësitë për rregullimin e sektorëve të ujit dhe mbeturinave nga UNMIK tek Institucionet e Kosovës

Sipas këtij ligji, ZRRUM është përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve të ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbimet të ujit, kanalizimit dhe mbeturinave të ngurta në Kosovë.

Aktualisht, shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë ofrohen nga 7 Kompani Regjionale të Ujit (KRU), të cilat janë të licencuara nga ZRRUM:

Tabela Nr. 1. Regjistri dhe emërtimi i kompanive të regjionalizuara:

Nr	Emërtimi i Kompanive	Vendndodhja e tyre
1	KUR "Prishtina" Sh. A.	Prishtinë
2	KUR "Radoniqi" Sh. A.	Gjakovë
3	KUR "Hidrodrini" Sh. A.	Pejë
4	KUR "Mitrovica" Sh. A.	Mitrovicë
5	KUR "Hidroregjioni-Jugor" Sh. A.	Prizren
6	KUR "Bifurkacioni" Sh. A.	Ferizaj
7	KUR "Hidromorava" Sh. A.	Gjilan

Për shkak të rrethanave ekzistuese të vendit jashtë sistemit të organizuar të sektorit të ujit në Kosovë kanë mbetur:

- 4 komunat serbe: Mitrovica e Veriut, Zubin Potoku, Leposaviqi dhe Shtërpca.
- Komuna e Novobërdës

- Sistemi i Deçanit i cili është shkëput me Vendim të Kuvendit Komunal të Deçanit nga regjioni i Pejës
- Sistemi i Kaçanikut i cili është shkëput me Vendim të Kuvendit Komunal të Kaçanikut nga regjioni i Ferizajt

Aktualisht, rregullimi i sektorit të ujit në Kosovë bëhet nga 3 autoritete rregullatore, dhe atë nga:

- **ZRRUM**, si rregullator i pavarur ekonomik, që ka përgjegjësi licencimin, përcaktimin e tarifave, dhe mbikëqyrjen e performancës së kompanive regjionale të ujit;
- **MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**, si rregullator mjedisor, që ka përgjegjësi dhënien e lejeve ujore për shfrytëzime të ndryshme si dhe dhënien e lejeve për shkarkimin e ujërave të zeza (kanalizimit); dhe
- **IKSHP – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik**, si rregullator i cilësisë së ujit, që ka përgjegjësi të përcaktojë dhe mbikëqyrë standardet e kualitetit të ujit të pijes që distribuohen nga kompanitë regjionale të ujësjellësit.

1.2 Kapacitet Ujore në Kosovë

Sipërfaqja ujëmbledhëse topografike e Kosovës është 11 645 km², që është 5 % më e madhe se sa sipërfaqja administrative politike (10 887 km²), që do të thotë se pjesa më e madhe e ujërave të Kosovës formohen brenda hapësirës së saj gjeografike.

Kosova ndahet në katër pellgje lumore: Pellgu i Lumit Drini i Bardhë, Pellgu i Lumit Ibër, Pellgu i Lumit Lepenci dhe Pellgu i Lumit Morava.

Ujërat e Kosovës u takojnë tre pellgjeve detare: Pellgut të Detit të Zi, Pellgut të Detit Adriatik dhe Pellgut të Detit Egje.

Prurja mesatare e ujërave nga rajoni perëndimor është 59,7 m³/s, ndërsa nga rajoni lindor 29,5 m³/s, që tregon për deficitin e ujërave në Kosovë. Me qëllim të sigurimit të ujit të pijshëm, për industri dhe ujitje janë ngritur liqenet artificiale: Liqeni i Badovcit, Liqeni i Batllavës, Liqeni i Ujmanit, Liqeni i Livoçit, Liqeni i Përlepnicsë dhe ai i Radoniqit.

Nga harta e paraqitur e pellgjeve lumore në territorin e vendit tonë mund të vërehet se është një rrjet relativisht i mirë i mbulimit të vendit me rrjedhje ujore, por është evidente se prurjet e tyre janë të kufizuara dhe duhet menduar për të gjetur zgjidhje afatmesme dhe afatgjate.



2. INVESTIMET KAPITALE NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

2.1. Investimet Kapitale në frymën e procesit tarifor

Deri në fund të vitit 2008, me tarifa janë mbuluar të gjitha shpenzimet operative për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe një pjesë e investimeve të domosdoshme kapitale për riparime e mirëmbajtje dhe për zgjerim të kapaciteteve të tij, sikurse që janë lejuar edhe shuma të caktuara të llogarive të arkëtueshme të pa-mbledhshme.

Me ndryshimin e politikave të përcaktimit të tarifave, është kaluar nga tarifa një-vjeçare në tarifa tre-vjeçare, ku përveç kostove operative janë marrë në konsideratë investimet kapitale që janë planifikuar nga KRU-të dhe të cilat pastaj janë miratuar nga DFT/ZRRUM, amortizimi i aseteve ekzistuese, kthimi në Vlerën Rregullatore të Kapitalit, etj. Për herë të parë DFT/ZRRUM ka identifikuar në dokumentacionin e mbledhur dhe ka bërë kategorizimin në dy shërbime, dhe atë: **shërbimet ujësjellësit** dhe **shërbimet e kanalizimit**. Më pastaj, asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asetet e infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**.

Për këto dy shërbime janë planifikuar shuma të konsiderueshme të mjeteve financiare për realizim të një numri të madh të projekteve investive të cilat ndërlidhen me asetet për shërbimet e ujit dhe kanalizimit.

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** janë të ndara në investime të cilat bëhen për qëllime të zëvendësimit të infrastrukturës dhe në investime të zgjerimit të infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha asetet mbitokësore siç janë: fabrikat për trajtimin e ujit, ndërtesat administrative, mjetet transportuese, pajisjet për zyrë etj.

Pasqyrat e Investimeve Kapitale të paraqitura për secilën kompani tregojnë investimet e planifikuara dhe të miratuara nga DFT/ZRRUM për periudhën e ardhshme tri vjeçare: 2009, 2010 dhe 2011. Këto investime janë të bazuara në të dhënat e kompanive, të dorëzuara me rastin e aplikimit për procesin e përcaktimit të tarifave të viteve 2009-2011.

Për Investimet e prezantuara nga Kompanitë dhe të miratuara nga DFT/ZRRUM është obligim i rregullatorit që të bëjë monitorimin e tyre për së afërmi, pasi që kostoja e Investimeve Kapitale të financuara nga mjetet vetanake të kompanive kanë ndikuar në tarifën aktuale për shërbimet e ujit dhe kanalizimit.

2.2 Lartësia e Investimeve Kapitale në Sektorin e Shërbimeve të Ujit

Në këtë dokument janë përmbledhur investimet kapitale të propozuara nga ana e KRU-ve gjatë procesit tarifor për periudhën 2009-2011, e të cilat janë të aprovuara nga ZRRUM pas shqyrtimit gjithëpërfshirës të tyre. Para se të paraqesim shumat e investimeve veç e veç për çdo kompani, në formë të përmbledhur, do të paraqesim shumën e përgjithshme të investimeve të planifikuara për realizim nga të gjitha kompanitë e regjionalizura gjatë vlefshmërisë së tarifave të këtij cikli tariforë, me sektorët e investimeve, burimet e tyre financiare dhe afatet kohore për realizim.

Tabela Nr. 2. Shuma e planifikuar e investimeve në sektorin e ujit gjatë viteve 2009 – 2011

Investimet kapitale të planifikuara nga KRU-të dhe lejuara nga ZRRUM	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacione €	Vetjake €	Donacione €	Vetjake €	Donacione €
Investimet Kapitale te planifikuara për Shërbimet e Ujësjiellësit	6,161,700	21,344,000	6,117,900	27,947,000	6,182,050	26,375,600
Investimet Kapitale te planifikuara për Shërbimet e Kanalizimit	1,012,500	12,396,400	1,659,700	15,900,400	2,072,000	14,348,500
Shuma e Investimeve te planifikuara sipas burimeve të financimit	7,174,200	33,740,400	7,777,600	43,847,400	8,254,050	40,724,100
Shuma totale e Investimeve te planifikuara nëpër vite	40,914,600		51,625,000		48,978,150	
Shuma totale e Investimeve të planifikuara për periudhën	141,517,750					
Shuma e Investimeve të aprovuara nga ZRRUM	4,397,531	33,740,400	7,243,262	43,847,400	10,262,058	40,724,100
Shuma totali e Investimeve të lejuara në sektorin e ujësjiellësit dhe kanalizimit	140,214,751					

Në vijim të dokumentit janë dhënë në formë të detajuar të dhënat për investimet e miratuara për realizim për secilën nga shtatë KRU-të. Të dhënat janë paraqitur sipas njësive të shërbimit, burimeve të financimeve dhe afateve kohore për realizim.

3. PËRSHKRIMI I INVESTIMEVE KAPITALE SIPAS KRU-ve

3.1. Kompania e Ujësjellësit Regjional “Prishtina” – Sh. A. Prishtinë

Furnizimi me ujë i Prishtinës daton që nga kohët e hershme nga burimet natyrale të Gërmisë, kurse më vonë nga pusët e ashtuquajtura të Kolevicës. Në vitin 1961 Prishtina kishte 38 593 banorë, në këtë vit fillon shfrytëzimi i akumulacionit të ujit të Liqenit të Badovcit për furnizim me ujë të pijes të qytetit të Prishtinës dhe rrethinës së tij. Ndërsa fillimi i shfrytëzimit të Liqenit akumulues të Batllaves është bërë nga viti 1983 me të cilin burim janë ngritë dukshëm sasitë e ujit të distribuuar te konsumatorët e shërbyer. Pas mbarimit të luftës Ujësjellësi Regjional “Batllava “ i është nënshtruar një transformimi dhe konsolidimi regjional, dhe në vitin 2007 përfundimisht shndërrohet në Shoqëri Aksionare me emërtimin Kompania e Ujësjellësit Regjional “**Prishtina**” Sh.A Prishtinë.

KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë, ofron shërbimet e veta në këto zona të shërbimeve:

- *Prishtinë*
- *Fushë Kosovë*
- *Obiliq*
- *Shtime*
- *Lipjan*
- *Podujevë*
- *Glllogoc – Drenas*



Numri i banorëve që shërbehen nga KUR “Prishtina” Sh. A., është rreth 550 000 banorë. Kjo e dhënë është marrë nga Plani i Biznesit të vet kompanisë të vitit 2008–2012. Aktualisht, shfrytëzueshmëria e kapaciteteve të ujit të furnizuar në këtë periudhë kohore sillet rreth 1200 l/sec.

KUR “Prishtina” Sh. A. , ka dy fabrika për trajtimin e ujit:

- *Albanikun* te Liqeni i Batllavës, dhe
- *Badovcin* te Liqeni i Badovcit

Po ashtu ka edhe 6 burime tjera nëntokësore, të cilat janë:

- *Kroni,*
- *Kastrioti,*
- *Shtimja,*
- *Lipjani,*
- *Podujeva dhe*
- *Drenasi.*

Kompania ka në shfrytëzim edhe shumë asete të tjera nga të cilat po numërojmë më të rëndësishmet e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit:

- 22 stacione Pompash
- Rezervuar të ujit në kapacitet (vëllim) total $V = 70\,000\text{ m}^3$
- 600 000 m gypa primar dhe sekondar të ujit të pijes
- 250 000 m gypat të kanalizimit për grumbullimin e ujërave të ndotura

Tabela Nr. 4.1. Të dhënat historike të vitit 2008 dhe ato të planifikuara 2009-2011

Të dhënat	Njësia	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011
Prodhimi vjetor i ujit	m ³	40 832 446	44 628 000	45 720 000	46 860 000
Humbjet e ujit	%	46	45	42	39
Faturimi	€	9 147 772	11 495 802	13 344 299	15 117 196
Inkasimi	€	6 029 568	8 297 216	10 140 076	11 984 288
Përqindja e Inkasimit	%	66	72	76	79

3.1.1. Pasqyra Tarifore e KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për vitet 2009 -2011

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë në formë tabelare tarifat e aplikueshme për KRU Prishtina për periudhën 2009-2011, të cilat janë aprovuar nga ZRRUM në fund të vitit 2008.

Tabela Nr. 4.2. Pasqyra e tarifave të përcaktuara nga DFT/ZRRUM për vitet 2009, 2010 dhe 2011

Lloji i tarifave	Njësia	Tarifat shtëpiakë				Tarifat jo-shtëpiakë			
		2007/08	2009	2010	2011	2007/08	2009	2010	2011
Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00	3.00
Volumetrike-ujë	€/m ³	0.25	0.30	0.32	0.34	0.60	0.72	0.76	0.81
Kanalizim	€/m ³	0.05	0.03	0.04	0.04	0.05	0.07	0.09	0.10
Tarifa mesatare volumetrike	€/m ³	0.30	0.33	0.36	0.38	0.65	0.79	0.85	0.91
Ngritja e tarifës në vite	%		10.00%	9.09%	5.56%		21.54%	7.59%	7.06%

3.1.2. Investimet Kapitale të KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për vitet 2009 -2011

Pasqyra e paraqitur më poshtë tregon shumën e investimeve të planifikuara nga KUR "Prishtina" dhe të miratuara nga ana DFT/ZRRUM, për periudhën kohore të ekzistimit të këtyre tarifave.

Tabela Nr. 4.3. Shuma e përgjithshme e investimeve nëpër vite

KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €
Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësjes	2475400	14 469 000	2 547400	22 073 300	2 945 200	18 540 000
Investimet Kapitale për Shërbimet e Kanalizimit	369 000	1 698 000	477 000	5 700 000	403 000	5 500 000
Shuma e Investimeve sipas burimit të financimit	2 844 400	16 167 000	3 024 400	27 773 300	3 348 200	24 040 000
Shuma e Investimeve nëpër vite	19,011,400		30,797,700		27,388,200	
Shuma totale e Investimeve në periudhën: 2009 -2011	77,197,300					
Shuma e Investimeve të lejuara nëpër vite	1,679,746	16,167,000	2,926,934	27,773,300	4,572,598	24,040,000
Totali i investimeve të lejuara për vitet 2009-2011	77,159,578					

3.1.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësjellësit

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat detaje për investimet kapitale të planifikuara nga KRU Prishtina dhe të miratuara nga ZRRUM për shërbimet e ujësjellësit në formë të projekteve specifike (tabela 4.4 dhe 4.5). Investimet infrastrukturore janë paraqitur si të ndara nga ato jo-infrastrukturore.

Tabela nr. 4.4. Lista e investimeve kapitale infrastrukturore për shërbimet e ujësjellësit

Emri i Projektit	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacion€	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €
2.11. Rehabilitimi dhe izolimi i të gjitha rezervuareve egzistuese	50,000.00	0	100,000.00	0	50,000.00	0
7.2 Ndërtimi i pusetave për monitorim dhe vendosje të paisjeve	0	100,000.00	0	0	0	0
5.5 Ndërtimi i pusetave të reja	30,000.00	100,000.00	30,000.00	100,000.00	30,000.00	0
3.2 Rehabilitimi i 12 filtrave / ndërrimi i rërës në Albanik	0	250,000.00	0	0	0	0
4.2 Krijimi i zonave mbrojtëse të burimeve largimi i ndotësve potencial - largimi (trajtimi) i ujërave të zeza që rrezikojnë liqenet akumuluese, kanalën e IL dhe zonat e ujërave nëntokësore	50,000.00	0	0	500,000.00	100,000.00	500,000.00
5.1 Aftësimi i të gjithë klorinatorëve të gazët në të gjitha pikat dozuese	10,000.00	0	10,000.00	0	10,000.00	0
6.2 Vendosja / aftësimi i paisjeve për dozimin automatik të klorit	0	0	0	0	100,000.00	0
6.4 Vendosja/aftësimi i paisjeve për neutralizimin automatik të klorit në rast të avarive (tushave)	30,000.00	0	0	0	0	0
1.4 Furnizimi / riparimi i pompave dhe motorëve në të gjitha SP të zonës së shërbimit	30,000.00	0	30,000.00	0	30,000.00	0
2.3 Zavendësimi i ndërprerësve ndarës Park, Mirëditë, Kodra I, Drejto	0	0	60,000.00	0	60,000.00	0
2.4 Ndërrimi i kabllove nga dy shtyllat furnizuese në SP Batllavë 35 kV	35,000.00	0	0	0	0	0
3.1 Zallitja dhe ngjyrosja e gypave në galeritë e gypave: në rezervuare , kulla marrëse, SP etj	25,000.00	0	25,000.00	0	25,000.00	0
3.2 Ndërrim mirëmbajtja e valvulave të sistemeve	30,000.00	0	30,000.00	0	100,000.00	0
4.3 Ndërrimi i gypave AC DN 450, 300 mm, L = 1100 m, dalja e rez. të Mirditës	0	400,000.00	0	0	0	0
4.7 Ndërrimi i gypave primar në tërë zonën e shërbimit ku mund të paraqiten rrjedhje të mëdha apo pasiguri e operimit L = 1000 m	50,000.00	0	50,000.00	0	50,000.00	0
5.1 Ndërrim i tubacioneve me rrjedhje të mëdha dhe i atyre ku bëhen meremetimet e rrugëve neper te gjitha komunat 12 km/vit	250,000.00	750,000.00	400,000.00	1,600,000.00	500,000.00	1,000,000.00
5.2 Ndërrimi i rrjetit të ujit ne sistemin e puseve Kroni	30,000.00	250,000.00	0	0	0	0
5.4 Punë tokësore me rastin e zbulimit dhe sanimit të rrjedhjeve	80,000.00	0	100,000.00	0	150,000.00	0
6.1 Ndërrimi i gypave të AC DN 80 - DN 200 L = 20000 m	0	400,000.00	0	450,000.00	0	0

6.2 Ndërrimi i gypave të lidhjeve të konsumatorëve DN 25 - DN 50 L = 15000 m	0	110,000.00	0	200,000.00	0	0
6.3 Kthimi i rrugës në gjendjen e mëparshme pas ndërrimeve të rrjetit	0	200,000.00	0	300,000.00	0	0
7.8 Furnizimi dhe trajnimi i stafit për shfrytëzimin e detektorëve të rrjedhjeve	0	150,000.00	0	0	0	0
8.3 Riparimi i ujëmatësve ekzistues	0	0	0	700,000.00	0	0
3.1 Pastirimi i kolektorit kryesor të Prishtinës 6000 m	0	200,000.00	0	200,000.00	0	0
1.8 Trajnime, ngritje e kapaciteteve njerëzore	20,000.00	28,000.00	30,000.00	0	30,000.00	0
4.1 Ndërrimi i gypit të çelikut Penda - SP Badovc, DN 700 mm, L = 1500 m	70,000.00	0	100,000.00	0	0	0
4.2 Ndërrimi i gypit Arbëri - Park DN 700, 600, 500 mm, L = 2000 m	0	1,200,000.00	0	0	0	0
4.4 Ndërrimi i gypit Kodra I - Kodra II DN 400 mm, L = 1200 m	0	350,000.00	0	0	0	0
4.5 Ndërrimi i gypit kryesor në Lypjan DN 350 mm, L = 1000 m.	50,000.00	150,000.00	0	0	0	0
4.6 Vazhdimi i gypit Albanik - Podujevë DN 400 mm,	50,000.00	200,000.00	0	0	0	0
4.8 Ndërrimi i gypit shkabaj - obiliq DN 500 mm, l=2000 m	0	0	100,000.00	300,000.00	0	0
4.9 Ndërrimi i gypit Mirëditë II - Kashagi DN 500 mm, l=3000m	0	0	0	0	250,000.00	0
5.3 ndërrimi i rrjetit te ujit dhe ndertimi i rezervuarit per fshatrat e Fushe Kosoves	60,000.00	350,000.00	0	0	0	0
7.3 Vendorsja e Hidrantëve	0	500,000.00	0	0	0	0
7.4 Vendorsja e valvolave reduktuese	0	0	0	500,000.00	0	0
7.5 Vendorsja e matësve të rrjedhjes dhe presionit, me dhënës digjital të informatave	0	0	0	1,500,000.00	0	0
7.6 Vendorsja e valvolave të zonave	0	0	0	500,000.00	0	0
1.1 Lagja Mati PR Φ 400 mm L = 700 m	0	0	0	0	0	0
1.2 Rr. Gjergj balshaj Φ 400 mm L = 400 m	0	0	0	0	0	0
1.3Rr. Kadri Zekj PR, Φ 315 mm L = 350 m	0	0	0	0	0	0
1.4 Rr. Afrim Abazi PR, Φ 315 mm L = 300 m	0	12,000.00	0	0	0	0
1.5 Rr. Afrim Gashi PR, Φ 310 mm L = 300 m	0	12,000.00	0	0	0	0
1.6 Rr. Naum Veqilharxhi FK, Φ 315 mm L = 300 m	0	12,000.00	0	0	0	0
1.7 Rr. Hamdi Grajqevci FK, Φ 315 mm L = 250 m	0	0	0	10,000.00	0	0
1.8 Rr. Tomorri, Φ 250 mm; L= 150 m	0	7,000.00	0	0	0	0
1.9 Ndërtimi i kolektorit të ri LY, me gypa të betonit Φ1000 mm; L= 550 m	20,000.00	0	0	0	0	0
1.10 Fshati Rashincë LY, t Φ 315 mm L = 1500 m	0	0	0	60,000.00	0	0
1.11 Fshatrat Caralevë, Belinc, Raçak, SHT Φ 400 mm L = 12000 m	0	80,000.00	0	100,000.00	0	100,000.00

1.12 Fshatrat Godanc i Ulët, Lagja e Pajtim, Godanci i Epërm, Mollopc, Petrovë, SHT Φ 315 mm L = 16000 m	0	40,000.00	0	150,000.00	0	200,000.00
1.14 Fshati Lathishtë, Sibovc, Hamidi KA, Φ 315 mm L = 680 m	0	130,000.00	0	142,000.00	0	0
1.15 Drenasi III, DR Φ 315 mm L = 1500 m	0	20,000.00	0	10,000.00	0	0
1.16 Drenasi i Ri, DR Φ 315 mm L = 4000 m	0	300,000.00	0	30,000.00	0	40,000.00
1.17 Ndërimi I rrjetit ne Podujev D=250 mm l=2000 m	20,000.00	100,000.00	20,000.00	80,000.00	20,000.00	0
1.9 Fushata Vetëdijesimi	30,000	78,000	30,000	0	30,000	0
1.18 Ndërimi I rrjetit ne Obiliq D=250 mm dhe d=300mm l=2000 m	20,000.00	150,000.00	30,000.00	100,000.00	35,000.00	0
(1)Të hyrat nga taksa e kyqjes të destinuara për Investime Kapitale	119,600	0	89,700	0	59,400	0
Totali i investimeve	1,159,600	6,629,000	1,234,700	7,532,000	1,629,400	1,840,000

Tabela nr. 4.5. Lista e investimeve kapitale jo-infrastrukturore për shërbimet e ujësjellësit

Emri i Projektit	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €
1.1 Riaktivizimi dhe shfrytëzimi i puseve në Kolovicë PR 70 (l/s)	0	600,000.00	0	0	0	0
1.2 Riparimi dhe hapja e puseve të reja te Kroni FK 60 (l/s)	60,000.00	0	0	0	0	0
1.3 Hapja e puseve në Henc 100 (l/s)	0	0	0	0	0	0
1.4 Hapja e Puseve në Lypjan 60 (l/s)	50,000.00	0	0	0	0	0
1.5 Hapja e puseve në Shtime 40 (l/s)	20,000.00	0	0	0	0	0
1.6 Hapja e puseve në Kastriot 30 (l/s)	20,000.00	0	0	0	0	0
1.7 Hapja e puseve në Peran 45 (l/s)	30,000.00	0	30,000.00	0	0	0
1.8 Ndërtimi i Impijantit të ri në Shkabaj (faza e parë)	0	5,000,000.00	0	10,000,000.00	0	15,000,000.00
2.1 Ndërtimi i rezervuarit në Badovc V = 3000 (m3)	0	300,000.00	0	300,000.00	0	0
2.2 Ndërtimi i 2 rezervuareve në Lypjan V = 2 X 250 (m3)	75,000.00	0	0	0	0	0
2.3 Ndërtimi i rezervuarit në sistemin e rrafshit Shtime V = 300 (m3)	60,000.00	0	0	0	0	0
2.4 Ndërtimi i rezervuarit të ri afër pishave Shtime V = 500 (m3)	0	100,000.00	0	0	0	0
2.5 Ndërtimi i rezervuarit në për Carralevë, Shtime V = 150 (m3)	0	0	0	0	0	0
2.6 Ndërtimi i rezervuarit në Drenas V = 1000 (m3)	0	0	0	0	0	0
2.10 Ndërtimi i rezervuarit te ri ne sistemin e furnizimit Kroni V=2000 (m3)	0	0	100,000.00	300,000.00	0	0
3.1 Ndërtimi i filtrave të ri në Badovc Q = 100 (l/s)	0	200,000.00	0	210,000.00	0	0
3.3 Ndërtimi i 1 filtri në Drenas Q = 30 (l/s) dhe pompave për filtrim	0	0	60,000.00	250,000.00	0	0
3.4 Ndërtimi i hidrostationit në Kodrën e Trimave për furnizimin e konsumatorëve në kotat e larta Q = 70 (l/s), H = 75 (m)	0	100,000.00	0	0	0	0

3.5 Ndërtimi i filtrave (të mbyllur apo të hapur) për sistemin e Kronit Q = 250 l/s	0	0	200,000.00	0	200,000.00	0
4.1 Rrethimi fizik i burimeve të ujit (liqeneve akumuluese dhe zonave të puseve nëntokësore)	0	0	0	500,000.00	0	500,000.00
5.2 Vendorsja e klorinatorëve të ri për pikat e reja të dozimit	10,000.00	0	10,000.00	0	10,000.00	0
5.3 Instalimi i sistemit paralel për dozimin e Klorurit të Natriumit apo Twin Oksidit në të gjitha pikat dozuese.	30,000.00	0	20,000.00	0	20,000.00	0
6.1 Vendorsja e analizatorëve për matjen e sasisë së klorit rezidual	30,000.00	30,000.00	50,000.00	0	50,000.00	0
6.3 Vendorsja e detektorëve për prezencën e klorit të gazët në ajër	50,000.00	0	0	0	0	0
6.5 Vendorsja e pajisjeve për monitorim dhe kontroll automatike dhe në largësi (on-line)	50,000.00	0	50,000.00	100,000.00	50,000.00	0
1.1 Furnizimi me motor rezervë (1) për SP Batllavë 800 kW	0	0	0	0	0	0
1.2 Furnizim me Hidropresë (tri pompa me rregullator të shpejtësisë për sistemin e trajtimit në Albanik Q = 8 l/s	15,000.00	0	0	0	0	0
1.3 Ndërtimi i SP të tipit Hidropresë në Lypjan Q = 60 (l/s)	40,000.00	40,000.00	0	0	0	0
1.5 Instalimi me rregullator të frekuencave për rregullimin e shpejtësisë së motorëve/pompave në: Mirditë, Park, Kodër, Lypjan, Kroni, Bivolak	0	100,000.00	0	250,000.00	100,000.00	0
2.1 Instalimi i kablilit furnizues dhe sigurimi i furnizimit alterantiv për SP Kroni 3 km, XHP 120 mm ² 24 kV	60,000.00	0	0	0	0	0
2.2 Ndërtimi i pajisjeve 10 kV me pajisje 10/20 kV për kyqje dhe distribuim Kroni	45,000.00	0	0	0	0	0
2.5 Instalimi i kabllove nga shtylla deri te hyrja e pajisjeve 10 kV Badovc	15,000.00	0	0	0	0	0
2.6 Kyqja e SP në Shtime në trafon kryesore,	0	0	0	0	0	0
2.7 Çvendsja dhe rehabilitimi i panelit për komandim në SP Shtime	15,000.00	0	0	0	0	0
7.1 Përgatitja e projektit për vendosjen e pusëve, montimin e Valvolave, Hidrantëve, Ujëmatësve, matësve të rrjedhjes dhe presionit, pajisjeve për monitorim dhe detektim	0	50,000.00	0	0	0	0
7.7 Instalimi i softwerit për monitorim të rrjedhjeve dhe shtypjeve në sistem, dhe SCADES	0	0	0	1,200,000.00	0	0
8.1 Ndërtimi i kyqjeve shtëpiake	60,000.00	750,000.00	100,000.00	700,000.00	150,000.00	700,000.00
8.2 Ndërtimi i ujëmatësve dhe vendosja e ujëmatësve të ri	70,000.00	160,000.00	80,000.00	100,000.00	100,000.00	100,000.00
8.4 Vendorsja e ujëmatësve me lexim në largësi	30,000.00	60,000.00	50,000.00	100,000.00	70,000.00	0
8.5 Rehabilitim dhe i punëtorisë për kalibrimin dhe riparimin e ujëmatësve	0	0	80,000.00	140,000.00	0	100,000.00
1.1 Ndërtimi i zyreve administrative / për punëtor: në Shtime, Drenas, Kastriot	70,000.00	0	60,000.00	0	80,000.00	0

1.3 Zgjerimi i kapacitetit të ngrohjes qendrore PR	40,000.00	0	0	0	50,000.00	0
1.4 Makina punese dhe Automjete për nevoja të kompanisë	80,000.00	0	80,000.00	0	100,000.00	0
1.1 Programe të licencuara	30,000.00	0	30,000.00	0	30,000.00	0
1.2 Harta Orto Foto dhe avcime te GIS-IT,dhe hatim projekteve	30,000.00	0	0	0	0	0
1.3 GPS	60,000.00	0	0	0	0	0
1.4 VPN (Virtual Private Network	0	0	35,000.00	0	0	0
1.5 Ndërrimi i rrjetit të mbrendshëm të komunikimit nga UPT në optik	0	0	0	0	30,000.00	0
1.6 Pajisje Hardwerike dhe avancim i softverit te Pronetit	10,000.00	0	20,000.00	0	10,000.00	0
1.7 Përkrahje Institucionale për GIS, Block Mapping, studime për Kontroll të ndotjeve të ujit dhe përmirësime në prodhimin e ujit, për një afat të mesëm Menaxhim i Sistemit të dhënave, Zbulim i rrjedhjeve, përgatitje të planeve për investime	0	350,000.00	0	391,340.00	0	300,000.00
2.7. Rehabilitimi i aeratorit në Badovc	0	0	0	0	0	0
2.8. Rehabilitimi i Rezervuarit dhe stacionit të pompave Lipjan	0	0	0	0	0	0
2.9. Rehabilitimi i Rezervuarit në Podujeve	0	0	0	0	0	0
1.2 Rehabilitimi (lyerja, izolimi, ndërtimi i ndonjë pjese) i të gjitha objekteve të kompanisë	50,000.00	0	60,000.00	0	70,000.00	0
2.8 Kompletimi i pikave matëse të energjisë elektrike për të gjitha pikat matëse të sistemi.	0	0	0	0	0	0
(2)Kërkesa për mirëmbajtjen kapitale	110,800	0	200,800	0	195,800	0
Totali i investimeve	1,315,800	7,840,000	1,315,800	14,541,340	1,315,800	16,700,000

3.1.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Kanalizimit Ujërave të Zeza

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat detaje për investimet kapitale të planifikuara nga KRU Prishtina dhe të miratuara nga ZRRUM për shërbimet e kanalizimit të ujërave të zeza në formë të projekteve specifike (tabela 4.6 dhe 4.7). Sikurse edhe në rastin e investimeve për shërbimet e ujësjellësit, edhe këtu investimet infrastrukturore janë paraqitur si të ndara nga ato jo-infrastrukturore.

Tabela nr. 4.6. Investimet kapitale infrastrukturore për shërbimet e kanalizimit të ujërave të zeza

Emri i Projektit	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €
4.1 Ndërtimi i sistemit për trajtimin e ujërave të zeza për Lypjanin	0	0	0	500,000	0	2,000,000
1.13 Vazhdimi i rrjetit të kanalizimit në Shtime Ø 4000 mm L = 3000 m	50,000.00	0	0	0	0	0
4.2 Ndërtimi i sistemit për trajtimin e ujërave të zeza për Podujevë	0	0	0	500,000	0	2,000,000
(3) Të hyrat nga taksa e kyqjes të destinuar për Investime Kapitale në Ujëra të Zeza	102,000	0	77,000	0	52,000	0
Totali i investimeve	152,000	0	77,000	1,000,000	52,000	4,000,000

Tabela nr. 4.7. Investimet kapitale jo-infrastrukturore për shërbimet e kanalizimit të ujërave të zeza

Emri i Projektit	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €
5.1 Përgatitja e projektit për Sistemin e Trajtimt të Ujërave të Zeza për Prishtinën, Kastriotin, Fushë Kosovën,	50,000	400,000	100,000	800,000	0	0
5.2 Përgatitja e projektit për Sistemit e Trajtimt të Ujërave të Zeza për Drenasin,	50,000	50,000	50,000	0	0	0
5.3 Përgatitja e projektit për Sistemit e Trajtimt të Ujërave të Zeza për Shtimen,	50,000	50,000	50,000	0	0	0
2.1 Inspektimi i 200 km të linjave të kanalizimit (me kamerë)	0	198,200	0	0	0	0
2.2 Riparimi i rrjetave të kanalizimit dhe i kyqjeve të shtëpive dhe kthimi i gjendjes së mëparshme të rrugëve në të cilat punohet L = 18000 m	60,000	1,000,000	200,000	3,900,000	350,000	1,500,000
4) Kërkesa për mirëmbajtjen kapitale për asetet e Ujërave të Zeza	6,900	0	0	0	0	0
Totali i investimeve	216,900	1,698,200	400,000	4,700,000	350,000	1,500,000

3.2. Kompania e Ujësjellësit Regional “Radoniqi” – Sh. A Gjakovë

KUR “Radoniqi” Sh. A, Gjakovë është kompani që furnizon me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit pjesën Jug-Perëndimore të Kosovës, e cila është themeluar nga 01.01 1986.

KUR “Radoniqi” Sh. A. Gjakovë, ofron shërbimet e veta në këto zona të shërbimeve:

- Komuna e Gjakovës me 41 fshatra
- Komuna e Rahovecit me 8 fshatra
- Komuna e Prizrenit me 13 fshatra

Numri i banorëve që shërbehen nga KUR “Radoniqi” Sh. A. Gjakovë është rreth 220 000 banorë.

KUR “Radoniqi” Sh. A. ka fabrikën përpunimit të ujit në fshatin Zhdrellë me kapacitet prodhues prej 600 l/s. Kjo Fabrikë merr ujin nga Liqeni i Radoniqit që ka kapacitet prej 113 000 000 m³, i cili furnizohet me ujë nga Lumëbardhi i Deçanit përmes kanalit derivues nga Lluka e Epërme deri te Lajthijat, pastaj nëpërmes kanalit natyral derdhet në liqe.



Kjo kompani ka në shfrytëzim edhe shumë asete të tjera nga të cilat po numërojmë:

(a) Rezervuarët:

- Dy rezervuar në Qërim me kapacitet prej 2x5000 m³
- Tre rezervuar në Rahovec me kapacitet 3x4250 m³
- Dy rezervuar në Breg Drin me kapacitet 2x850 m³
- Dy rezervuar në Krajë me kapacitet 2x120 m³
- Një rezervuar në Palabardh 1x400 m³

(b) Stacionet e Pompimit:

- Një stacion pompimi Reti
- Një stacion pompimi në Breg Drini
- Një stacion pompimi në Sopot
- Dy stacione pompimi në Rahovec

(c) Rrjeti i Ujësjellësit:

- Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit është 551 388 m, me diametër të gypit Φ 50 deri Φ 100 mm.

Tabela Nr. 5.1. Të dhënat historike të vitit 2008 dhe ato të planifikuara (2009-2011)e

Të dhënat	Njësia	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011
Prodhimi vjetor i ujit	m ³	17,047,774	17,757,802	17,225,068	17,835,864
Humbjet e ujit	%	62	50	48	47
Faturimi	€	2,461,809	3,523,360	3,758,572	4,073,564
Inkasimi	€	1,756,631	2,741,924	3,012,064	3,367,004
Përqindja e Inkasimit	%	71	78	80	83

3.2.1 Pasqyra Tarifore e KUR "Radoniqi" Sh. A. Gjakovë për vitet 2009 -2011

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë në formë tabelare tarifat e aplikueshme për KRU Prishtina për periudhën 2009-2011, të cilat janë aprovuar nga ZRRUM në fund të vitit 2008.

Tabela Nr. 5.2. Pasqyra e tarifave të përcaktuara nga DFT/ZRRUM për vitet 2009, 2010 dhe 2011

Lloji i tarifave	Njësia	Tarifat shtëpiakë				Tarifat jo-shtëpiake			
		2007/08	2009	2010	2011	2007/08	2009	2010	2011
Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00	3.00
Volumetrike-ujë	€/m ³	0.25	0.27	0.28	0.29	0.55	0.57	0.62	0.64
Kanalizim	€/m ³	0.05	0.05	0.05	0.05	0.05	0.11	0.11	0.11
Tarifa mesatare volumetrike	€/m ³	0.30	0.32	0.33	0.34	0.60	0.68	0.73	0.75
Ngritja e tarifës në vite	%		6.67%	3.13%	3.03%		13.33%	7.35%	2.74%

3.2.2. Investimet Kapitale të KUR "Radoniqi" Sh. A. Gjakovë për vitet 2009 -2011

Pasqyra e më poshtme paraqet shumën e investimeve të planifikuara nga KUR "Radoniqi" Sha. A. Gjakovë dhe të miratuara nga ana e DFT/ZRRUM.

Tabela Nr. 5.3. Shuma e përgjithshme e investimeve nëpër vite

KUR “Radoniqi” Sh. A. Gjakovë	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €
Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësjetës	733,000	1,902,000	761,300	2,550,000	793,200	3,462,300
Investimet Kapitale për Shërbimet e Kanalizimit	57,700	376,700	50,000	430,000	98,600	540,000
Shuma e Investimeve sipas burimit të financimit	790,700	2,278 700	811,300	2,980,000	891,800	4,002,300
Shuma e Investimeve nëpër vite	3,069,400		3,791,300		4,894,100	
Shuma totale e Investimeve në periudhën: 2009 -2011	11,754,800					
Shuma e Investimeve të lejuara nëpër vite	57,050	2,278,700	1,142,693	2,980 000	1,426,580	4,002,300
Totali i investimeve të lejuara për vitet 2009-2011	12,787,323					

3.2.3. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujësjetës

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat detaje për investimet kapitale të planifikuara nga KRU Radoniqi dhe të miratuara nga ZRRUM për shërbimet e ujësjetës në formë të projekteve specifike (tabela 5.4 dhe 5.5). Investimet infrastrukturore janë paraqitur si të ndara nga ato jo-infrastrukturore.

Tabela nr. 5.4. Lista e investimeve Kapitale infrastrukturore për shërbimet e ujësjellësit

Emri i Projektit	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €
Investimet ne rrjet	75,000	0	80,000	0	83,000	0
Ujëmatësit Ø 3/4 - 6/4 -	5,000	0	10,000	0	15000	0
Ndërrimi I Valvulave ne rrjetin primar	8,000	0	13,000	0	15,000	0
Aktivizimi I ujëlëshuesve ne rrjetën kryesore	5,000	0	5,000	0	5000	0
Riparimi i valvuleve te vjetra	5,000	0	10,000	0	0	0
Ndërrimi I Rrjetit kryesore Gjakove	0	105,000	0	150,000	0	200,000
Ndërrimi I Rrjetit kryesore Rahovec	0	47,000	0	80,000	0	120,000
Ndërrimi I Rrjetit kryesore Lumbardhë	0	100,000	0	120,000	0	242,370
(1)Të hyrat nga taksa e kycje të destinuara për Investime Kapitale	35,000	0	23,300	0	35,200	0
Totali i investimeve	133,000	252,000	141,300	350,000	153,200	562,370

Tabela Nr. 5.5. Lista e investimeve Kapitale jo-infrastrukturore për shërbimet e ujëasjellësit

Emri i Projektit	2009		2010		2011	
	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €	Vetjake €	Donacion €
GIS	12,000	0	15,000	0	17,000	0
Detektor për zbulimin e rrjedhjeve	0	0	13,000	0	15,000	0
Laboratori Fiziko-kimik dhe Bakteriologjik	3,000	0	5,000	0	7,000	0
Investimet e paparashikuara si :Rrufeja, Vërshimet,Tërmetet.	13,500	0	15,000	0	18,000	0
Makina për prerjen e asfaltit dhe mini bageri	25,000	0	0	0	0	0
Investimet ne Makineri dhe Elektrik	4,000	0	4,500	0	6,000	0
Mekanika Stacioni I Filtrave	0	0	0	0	6000	0
Dispeçerja ne ST. E Filtrave-	6,000	0	0	0	0	0
Riparimi I kulmit ne St.e Filtrave-	0	0	0	0	0	0
Rezervari ne Stacionin e Filtrave-	6,000	0	0	0	0	0
Aparat saldues Ø 125mm	0	0	0	0	0	0
Automjetet	15,000	0	0	0	0	0
Aparat saldues Ø 315mm	8,000	0	10,000	0	0	0
Investimet ne Objektin e Drejtorisë	6,000	0	3,000	0	5,000	0
Peshore elektronike	0	0	0	0	2000	0
Matësi Ultrasonik për matjen e rrjedhjes	0	0	10,000	0	15,000	0
Ndërtesa e re ne njësinë e Rahovecit-	13,000	0	10,000	0	22000	0
Faza e Dyte e Stacionit te Filtrimit	0	1,000,000	0	1,500,000	0	2,000,000
Punimi I koritës ne kanalën derivues-pjesa e pakryer	0	650,000	0	700,000	0	900,000
(2)Kërkesa për mirëmbajtjen kapitale	488,500	0	534,500	0	527,000	0
Totali i investimeve	600,000	1,650,000	620,000	2,200,000	640,000	2,900,000

3.2.4. Investimet Kapitale për Shërbimet e Ujërave të Zeza

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat detaje për investimet kapitale të planifikuara nga KRU Radoniqi dhe të miratuara nga ZRRUM për shërbimet e kanalizimit të ujërave të zeza në formë të projekteve specifike (tabela 5.6 dhe 5.7). Sikurse edhe në rastin e investimeve për shërbimet e ujësjellësit, edhe këtu investimet infrastrukturore janë paraqitur si të ndara nga ato jo-infrastrukturore.

Tabela nr. 5.6. Lista e investimeve kapitale për shërbimet e ujërave të zeza në infrastrukturë

Emri i Projektit	2009		2010		2011	
	Vetanake €	Donacione €	Vetanake €	Donacione€	Vetanake €	Donacione €
Investimet ne rrjetin e Kanalizimit-	18,275	0	27,125	0	34,725	0
Investimet ne Kanalizim Gjakova	0	350,000	0	400,000	0	500,000
Investimet ne Kanalizim Rahoveci	0	26,700	0	30,000	0	40,000
Ndërrimi I rrjetit të vjetër	20,000		10,000		42,786	
(3) Të hyrat nga taksa e kycjës të destinuara për Investime Kapitale në Ujëra të Zeza	19,400	0	12,900	0	21,100	0
Totali i investimeve	57,675	0	50,025	0	98,611	0

3.3. Kompania e Ujësllësit Regional “Hidrodrini” – Sh.A. Pejë

KUR “Hidrodrini” Sh.A. Pejë është themeluar në tetor të vitit 2004 në bazë të marrëveshjes së përbashkët ndërmjet AKM-së (Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit) dhe pesë Komunave (Pejë, Deçan, Istog, Klinë dhe Junik), ndërkaq në Maj të vitit 2007 është themeluar si Shoqëri Aksionare e cila është e organizuar sipas ligjeve ekzistuese të Republikës së Kosovës.

KUR “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, ofron shërbimet e veta në këto zona të shërbimeve:

- Pejë
- Istog
- Klinë
- Junik

Zona e shërbimit të regjionit të Deçanit me një vendim të Kuvendit Komunal gjatë Qershorit të vitit 2006 ka shkëput njësinë e vetë të ujësllësit e cila ka vepruar në kuadër të KUR “Hidrodrini” Sh. A. Pejë dhe ka themeluar kompaninë vendore të vetën për ujësllës. ZRRUM konsideron se shkëputjet e tilla nuk kanë mbështetje ligjore dhe për funksionimin e tyre kërkohet miratimi i institucioneve qendrore të vendit .

Numri i banoreve që KUR “Hidrodrini” Sh. A., i shërben me ujë është rreth 177.767 banorë, ndërsa për shërbimet e ujërave të zeza janë rreth 54.950 banorë. Kapaciteti i prodhimit të ujit sillet rreth 30.000.000 m³/vit.



Njësia operative në Pejë:

